



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomisë

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bsc. Qendresa Krasniqi**, me titull: **“Preferencat e konsumatorëve ndaj disa produkteve perimore (Fasulja, Lakra, Shalqiri dhe Pjepri) në rajonin e Prishtinës”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data **05/04/2024** deri me datë **12/04/2024**.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra - kryetar/anëtar
2. Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi - mentor/anëtar
3. Prof. Dr. Skender Kaçiu - anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi, përmes e-mail adresës njazi.bytyqi@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

Preferencat e konsumatorëve përkufizohen si një grup supozimesh që fokusohen në zgjedhjet e konsumatorëve që rezultojnë në alternativa të ndryshme si nevoja, lumturia, vlera, kënaqësia ose dobia. Për shkak se preferenca e konsumatorit përcakton se cilat produkte do të blejnë dhe konsumojnë konsumatorët (njerëzit) brenda mundësive (buxhetit të tyre) të tyre të blerjes dhe bazuar sipas plotësimit të nevojave të tyre të konsumimit, na mundësoj të kuptojmë që ka preferencat e konsumatorëve kanë rëndësi shumë të madhe në treg si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendin tonë. Duke marrë parasysh që produktet perimore si: fasulja, lakra, shaqlini dhe pjepri janë një ndër produktet më të preferuar, pëlqyera dhe më të konsumuara në vendin tonë, nisur nga kjo mund të deklarojmë se duke pasur për bazë këtë fakt ishte edhe objektivi i këtij studimi i cili ka të bëjë me analizën e preferencave të konsumatorëve ndaj disa produkteve perimore (Fasulja, Lakra, Shalqiri dhe Pjepri) në rajonin e Prishtinës.

Hulumtimi u zhvillua me konsumatorëve e produkteve perimore në rajonin e Prishtinës (Prishtinë, Podujeve, Lipjan, Drenas, Fushë Kosovë, Obiliq), përkatësisht në vendet e furnizimit si supermarkete, dyqane ushqimore dhe tregje. Mostra e përzgjedhjes së pjesëmarrësve ishte e rastësishme, ku përmes intervistës me anë të pyetësorëve u grumbulluan të dhënat e këtij punimi. Madhësia e mostrës përbëhej prej 124 intervistave me konsumatorë produkteve perimore si fasules, lakrës, shalqinit dhe pjeprit. Këto të dhëna më pastaj janë regjistruar dhe përpunuar dhe analizuar përmes programeve Excel dhe SPSS.

Bazuar në të dhënat e prezantuara, mund të prezantojmë gjetjet tona në lidhje me preferencat e konsumatorëve ndaj produkteve të hulumtuar: Fasulja dhe Lakra janë produktet më të preferuara: Me respektivisht 32.3% dhe 30.6% të pjesëmarrësve që preferojnë këto produkte, duket se Fasulja dhe Lakra janë të dyja produktet më të preferuara nga popullsia e studiuar. Ndërsa Shalqini ka një nivel të rëndësishëm të preferencës gjithashtu. Pjepri, në anën tjetër, është më pak i preferuari në këtë grup. Këto informacione mund të ndihmojnë në marrjen e vendimeve të biznesit në lidhje me strategjitë e marketingut dhe oferta të produktit në treg.

Fjalët kyçe: Preferencat e konsumatorëve, produktet perimore, Fasulja, Lakra, Shalqiri dhe Pjepri, Rajoni i Prishtinës.